



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Konkursi Mbarëkombëtar i Krijimtarisë Muzikore

Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, në kuadër të vitit 2018, shpallur nga qeveria shqiptare “Viti mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, me përparësi për të aftësuar kapacitetet krijuese për artistë me ide inovative që i duan sfidat, shpall organizimin e Konkursit Mbarëkombëtar të Krijimtarisë Muzikore në gjinitë: Opera, Balet dhe Muzikal.

Ky konkurs synon të zhvillojë krijimtarinë muzikore dhe të nxjerrë në pah talentin, artin dhe frymëzimin e artistëve në gjinitë: Opera, Balet dhe Muzikal.

Konkursi kërkon të inkurajojë artistët në këto gjini të muzikës skenike, duke promovuar kreativitetin, afirmimin dhe dialogun në botën emocionuese të Muzikës, në një konkurs mbarëkombëtar.

Mirëpresim aplikime nga krijues shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, veprat e të cilëve do të interpretohen në format koncertal brenda muajit dhjetor 2018.

Produksionet e plota të vlerësuara fituese do të përfshihen në kalendarin artistik të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor.

Data të rëndësishme

11 Prill 2018: Hapja e Thirrjes Publike;

11 tetor 2018: Afati i dorëzimit të veprës;

31 tetor 2018: Vlerësimi dhe seleksionimi i veprave nga juria;

10 dhjetor 2018: Pjesë nga veprat premierë të kualifikuara për eventin final koncertal për publikun dhe dhënia e çmimeve nga Juria;

Viti 2019-2020: Realizimi i plotë skenik i veprave fituese të vlerësuara me çmim.

Kritere dhe udhëzime mbi pjesëmarrjen

Kushtet për pjesëmarrje:

- Kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë kompozitorët shqiptarë, me banim në Shqipëri ose jashtë saj.
- Krijuesit kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm me një vepër muzikore, në njërin nga kategoritë;
- Partiturat të cilat janë publikuar, ekzekutuar në publik apo që janë publikuara ose të regjistruara komercialisht para "Koncertit Final" nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë thirrje.
- Vepra duhet të paraqitet e shoqëruar me të gjitha elementët e plotë të saj, si krijimtari muzikore, krijimtari letrare dhe koreografike. *Në fazën e parë krijimtaria letrare dhe koreografike të paraqitet në formën e një koncepti.*

Kritere të përgjithshme:

- të diplomuar, kompozitorë me arsim të lartë;
- mosha pa limit;
- portofoli i veprimtarisë së krijuesit apo bashkautorëve (CV),
- adresën dhe të dhëna të tjera të vendbanimit;

Kohëzgjatja e veprave sipas gjinisë është përkatësisht;

- Opera (*minimumi 60 deri në 120 minuta*);
- Balet (*minimumi 60 deri në 120 minuta*);
- Muzikal (*minimumi 60 deri në 120 minuta*)

Çmimet:

- | | |
|--|----------------|
| • Opera (<i>pagesë për krijimtari operistike / libret</i>): | 3.000.000 lekë |
| • Balet: (<i>pagesë për krijimtari muzikore në balet / koreografi</i>) | 3.000.000 lekë |
| • Muzikal (<i>pagesë për krijimtari muzikore / koreografi dhe libretist</i>) | 3.000.000 lekë |
| • Çmimi i krijuesit të ri (<i>çmim inkurajues</i>): | 500.000 lekë |
| • Çmimi Publikut/Kritikës: | 500.000 lekë |

**Çmimet janë subjekt i tatimit sipas ligjit të taksave të Republikës së Shqipërisë.*

Të drejtat e autorit

Të drejtat e autorit do të zbatohen në përputhje me legjislacion në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Në rast se vepra muzikore kualifikohet apo shpallet fituese, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, ka të drejtën e përdorimit për vënien në skenë të veprës origjinale dhe të prejardhur që do të ekzekutohet nga trupat artistike të Institucionit të TKOBAP-së. Ky shfrytëzim nuk bie ndesh me shfrytëzimin normal të veprës së autorit apo mbajtësit të së drejtës.

Për rregullimin e marrëdhënieve mbi të drejtën e autorit palët do të nënshkruajnë një marrëveshje midis autorit/bashkautorëve të veprës dhe Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, për termat dhe rregullimin e mënyrës së përdorimit të veprës.

Juria dhe përbërja e saj:

Veprat e plota do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga një juri ndërkombëtare me 5 anëtarë. Në këtë juri do të bëjnë pjesë personalitete të mirënjohura me përbërje: kompozitorë, dirigjentë, kritikë arti, muzikologë, koreografë apo solistë vokal.

Procesi i për zgjedhjes:

Anëtarëve të jurisë do ti përcillen aplikimet online (*version elektronik*) të krijuesve. Pas shqyrtimit të veprave të paraqitura, juria në fazën e parë vlerëson dhe seleksionon veprat të cilat do të vijojnë konkurrimin për çmimet përkatëse dhe që meritojnë të vendosen në skenë për dëgjues publikë. Në rast për zgjedhjeje, kompozitori duhet të dorëzojë pjesët orkestrale apo/dhe korale, solistike (*partiture + partet e veçanta muzikore*) të veprës muzikore për pjesët e për zgjedhura për tu interpretuar në versionin koncertal.

Në ditën e ekzekutimit të veprave, në përfundim, Juria pas një procesi diskutimesh dhe votimi, vlerëson veprën fituese për secilin prej **kategorive apo çmimeve** të shpallura. Juria voton në mënyrë të fshehtë dhe vendimi i saj është i pakthyeshem. Çmimet shoqërohen me certifikatën përkatëse.

Juria mund të vendosë të ndajë çmimet ose të mos shpërblejë asnjë krijues më çmim. Vendimi i Jurisë është përfundimtar.

Vlerësimi i Jurisë do të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- Në krijimtarinë dhe cilësinë e partiturës si kriterin parësor vlerësues. Përdorimi i elementëve krijues të përbërjes muzikore, duke përfshirë në tërësi, por pa u kufizuar në formë, zhanër, ndjesi, melodi, harmoni, ritëm dhe tekstologji. Është shumë e rëndësishme që përmbajtja e partiturës të jetë e qartë, e saktë dhe një përfaqësim i denjë i punës së kompozitorit dhe bashkautorëve të tjerë;
- Në potencialin artistik për të sjellë risi në përmbajtje muzikore dhe për të reflektuar gjerësisht mbi tematikën e veprës apo në mbështetjen tek melosi tradicional i muzikës shqiptare;
- Qartësinë dhe forcën artistikë të veprës, për të komunikuar te publiku, audienca dhe kritikët, si dhe për të zhvilluar audienca të reja.

Instrumentacioni i mundshëm:

Harqe

8 violina të I-ra
6 violina të II-ta
6 viola
6 violonçela
4 kontrabasë

Të drunjtat

Flaut (I-II) III flaut piccolo
Oboe (I-II) III korno anglez
Klarinetë Sib/La (I-II) III- Klarinetë Bas
Fagot (I-II) III – Kontrafagot

Tunxhi

4 Korno
3 Trompa
3 Trombonë (2 tenor – 1 bas)

Perkusion

Instrumente të perkusionit janë të limituar, si më poshtë:

Timpani
Tambur militar
Piata
Grand Casa
Dajre
3 perkusionistë

Kori

12 soprano
12 alto
10 tenorë
10 bass

Solistë këngëtarë

4 soprano
2 mezzo soprano
2 tenore
3 bariton

Dokumentacioni i nevojshëm

Vepra duhet të paraqitet për konkurrim në dy variante:

Pranë protokollit të Ministrisë së Kulturës ose në rrugë postare:

- kërkesë me shkrim për pjesëmarrje në konkurs;
- koncepti i krijuesit apo bashkautorëve për veprën;
- koncepti për krijimtarinë letrare dhe koreografike që shoqëron veprën muzikore;
- kopje të partiturës së veprës muzikore;
- versioni Audio (demo) në CD;
- vet deklarim nga autori apo bashkautorët e veprës që vepra është premierë, e pa publikuar më parë në asnjë eveniment dhe e kompozuar enkas për këtë konkurs; *(format bashkëlidhur)*;
- vepra duhet të jetë e certifikuar nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit (DDA). *Dokumenti do të kërkohet në fazën e dytë.*

Aplikimi online:

- portofoli i veprimtarisë së krijuesit apo bashkautorëve (CV), (shqip dhe anglisht);
- koncepti i krijuesit apo bashkautorëve për veprën (shqip dhe anglisht);
- koncepti për krijimtarinë letrare dhe koreografike që shoqëron veprën muzikore (shqip dhe anglisht);
- partitura duhet të dorëzohet me shkrim kompjuterik version (PDF), shoqëruar me versionin audio demo (MP3, ose wave).

**Duke marrë në konsideratë se Juria do të jetë e përbërë nga personalitete të shquara të artit ndërkombëtar, për një vlerësim sa më objektiv është e domosdoshme që tekstet që shoqërojnë veprën muzikore, përveç variantit në gjuhën shqipe të jenë edhe të përkthyer në gjuhën angleze.*

Dorëzimi i dosjes:

Të dërgohet me postë (në formë të printuar) dhe format digjital, në vëmendje të sekretarisë teknike të Konkursit të Krijimtarisë Muzikore 2018, brenda datës 11 tetor 2018, në adresën:

Ministria e Kulturës

Rruga Aleksandër Moisiu, Nr.76;

Ish Kinostudio “Shqipëria e Re” Tiranë, Shqipëri.

Të dërgohet elektronikisht brenda orës 24.00, të datës 11 tetor 2018, në adresën:

krijimtariamuzikore2018@kultura.gov.al;

*Aplikimet e palexueshme, jo të plota apo përtej afatit nuk do të konsiderohen.

Për çdo pyetje apo paqartësi mund të dërgoni një e-mail në adresën:

krijimtariamuzikore2018@kultura.gov.al;